



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 204/2024
Datë: 26 shkurt 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenin 7 paragrafi 1 pika 11, 12 dhe nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Ligjit nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Z. Lulzim Aliu, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, sipas Raportit të Panelit Hetimor në rastin AD.nr. 33/2023, të datës 30 nëntor 2023, gjatë shqyrtimit të mbajtur me datë 13 shkurt 2024 dhe 26 shkurt 2024, në seancën për këshillim dhe votim mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** Raporti i panelit hetimor AD.nr. 33/2023, të datës 30 nëntor 2023, në rastin disiplinor ndaj Prokurorit Lulzim Aliu, Prokuroria Themelore në Prishtinë;
- II. **VËRTETOHET** se te Prokurori Lulzim Aliu, nuk janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, që bien ndesh me nenin 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.5 të Ligjit nr.06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- III. Prokurori Lulzim Aliu **LIROHET** nga përgjegjësia disiplinore pasi që nuk është provuar se ka kryer shkeljen e supozuar disiplinore.
- IV. **OBLIGOHET** Komisioni për Vlerësimin e Përformancës së Prokurorëve që gjatë vlerësimit të rregullt të performancës së Prokurorit Lulzim Aliu të trajtoj dhe vlerësoj të gjeturat e Raportit të Panelit Hetimor AD.nr.33/2023 dhe të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Më datë 16 nëntor 2023, ish Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Z. Kujtim Munishi, në cilësinë e Autoritetit Kompetent, pas ankesës së pranuar nga palët e

dëmtuara [REDACTED] dhe [REDACTED] ka paraqitur kërkesën AD.nr.33/2023, për fillimin e hetimit disiplinore ndaj Z. Lulzim Aliu, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me trajtimin e rastit [REDACTED] sipas ankesës së pranuar Prokurori Lulzim Aliu, gjatë trajtimit të lëndës së lartcekur (në kujdestari), nuk i ka trajtuar faktet në mënyrë objektive dhe profesionale, më konkretisht të njëjtit pretendojnë që përkundër faktit që kryerësit e veprës penale kanë qenë recidivist, prokurori i rastit ndaj tyre nuk ka paraqitur kërkesë për caktimin e paraburgimit, në këtë mënyrë të dëmtuarit kanë qenë pa mbrojtje.

Prokurori i çështjes nuk ka ndërmarrë veprimet konkrete procedurale, në këtë mënyrë nuk ka paraqitur kërkesën për caktimin e paraburgimit ndaj të dyshuarve përkundër faktit që është plotësuar kushti nga neni 184, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRK – së. Gjithashtu, marrë për bazë faktin se Prokurori Lulzim Aliu, është prokuror në fillim të mandatit, i njëjti nuk ka pranuar dhe ka refuzuar udhëzimet dhe ndihmën profesionale nga Udhëheqësja e Departamentit të Përgjithshëm, si udhëheqëse e drejtpërdrejtë e tij.

Më datë 30 nëntor 2023, Këshilli Prokurorial i Kosovës, me Vendimin KPK/Nr. 936/2023, ka themeluar Panelin Hetimor për hetimin e rastit disiplinore AD.nr.33/2023 ndaj Z. Lulzim Aliu, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Paneli Hetimor, në bazë të nenit 13 të Ligjit me Nr.06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Neni 14, paragrafi 7 dhe 8 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve ka propozuar marrëveshje vullnetare për zgjidhjen e kësaj çështje disiplinore, mirëpo pas refuzimit nga ana e subjektit të hetimit, Paneli Hetimor është lëshuar në hetimin e rastit disiplinor.

Më datë 18 janar 2024, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), nga Paneli Hetimor, ka pranuar Raportin AD.nr.33/2023, me të cilin Paneli Hetimor bazuar në provat e shqyrtuara ka vërtetuar pretendimet e Autoritetit Kompetent se prokurori Lulzim Aliu ka vepruar në shkelje të nenit 6, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse i njëjti gjatë trajtimit të lëndës [REDACTED], nuk i ka trajtuar faktet në mënyrë objektive dhe profesionale, përkundër faktit se kryerësit e veprës penale kanë qenë recidivist. Prokurori Aliu, në kohën kur janë kryer veprat penale ka qenë kujdestar dhe pas ndalimit të personave prej 48 orëve, të njëjtit i ka liruar dhe nuk e ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit, duke mos vlerësuar si duhet rrezikshmërinë e situatës si dhe të kryerësve të veprave penale, ku të dëmtuarit kanë qenë pa mbrojtje, kjo për faktin se të dyshuarit kanë poseduar të dhënat e tyre personale dhe janë ndjerë të frikësuar e të kanosur, ashtu që, të dyshuarve ju është lënë mundësia që të ndikojnë në fshehjen dhe asgjësimin e provave të veprave penale të kryera. Prokurori Aliu nuk i ka pranuar dhe ka refuzuar udhëzimet dhe ndihmën profesionale nga Udhëheqësja e Departamentit të Përgjithshëm,

si udhëheqëse e drejtpërdrejtë e tij, po ashtu i njëjti ishte njoftuar se, ishte marrë një qëndrim i përbashkët i të gjithë prokurorëve në kolegjiun që rastet kur kemi të bëjmë me recidivist ndaj tyre të ushtrohet kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 13 shkurt 2024, ka hapur seancën disiplinore ku subjekti i hetimit disiplinor, Prokurori Lulzim Aliu, ka kërkuar përjashtimin e [REDAKTUAR] Zëvendës Kryesuese e Këshillit Prokurorial të Kosovës, për pjesëmarrje në seancën disiplinore të KPK - ë, për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit. Pas aprovimit të kërkesës së subjektit të hetimit për përjashtimin e anëtares së këshillit [REDAKTUAR] seanca e datës 13 shkurt 2024, është ndërpre për të vazhduar pas plotësimit të kushteve për mbajtjen e seancës disiplinore në rastin.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26 shkurt 2024, ka vazhduar seancën për rastin disiplinor AD.nr.33/2023. Pas shqyrtimit të raportit të dorëzuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesuesit të Panelit Hetimor i cili i ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës disiplinore. Në seancën disiplinore ka prezantuar edhe subjekti i hetimit disiplinor, Prokurori Lulzim Aliu, i cili në mbrojtjen e tij ka cituar se: " Sa i përket Raportit nuk do të deklarohe fare, për shkak se krejt i kam thënë në shënimin zyrtar dhe gjatë intervistimit para Panelit Hetimor ". Në shënimin zyrtar i njëjti ka deklaruar se: " Rrjedhimisht, mbase jam edhe subjektiv në këtë vlerësim, por në veprimet e mia nuk kam gjetur asnjë gabim si në kuptim të zbatimit të procedurës ashtu edhe sa i përket vlerësimit të rrethanave lidhur me vendimin tim për ndalimin e të dyshuarve për 48 orë si dhe përkitazi me vendimin tim për t'i liruar ata në procedurë të rregullt. Mirëpo, për qëllime të këtij shënimi zyrtar në mënyrë që të jetë i plotë dhe të përfshijë të gjitha aspektet, unë jam detyruar që ta analizoj edhe veprimin e udhëheqëses [REDAKTUAR] fillimisht për nga aspekti i ndërhyrjes në autonominë e prokurorit të çështjes gjatë vendimmarrjes në rastet individuale e pastaj edhe për nga aspekti i përshtatshmërisë, respektivisht rregullave të sjelljes profesionale, sidomos duke pasur parasysh pozitën e saj drejtuese në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Sa i përket ndërhyrjes në pavarësinë dhe autonominë e vendimmarrjes, për këtë qëllim, i kam konsultuar këto dokumente ligjore në fuqi: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës Nr.08/L-032, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës ".

Këshilli Prokurorial i Kosovës, bazuar në të gjeturat e panelit hetimor, sigurimin e të gjitha fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me rastin disiplinor AD.nr.33/2023, me shumicë të votave vendosi ta refuzoj raportin e panelit hetimor, përkundër faktit se paneli ka gjetur se, subjekti i hetimit disiplinor bazuar në provat e shqyrtuara ka vërtetuar se i njëjti gjatë shqyrtimit të lëndës [REDAKTUAR] nuk i ka trajtuar faktet në mënyrë objektive dhe profesionale, përkundër faktit se kryerësit e veprës penale kanë qenë

recidivist, prokurori Aliu në kohën kur janë kryer veprat penale ka qenë kujdestar dhe pas ndalimit të personave prej 48 orëve, të njëjtit i ka liruar dhe nuk e ka paraqitur kërkesën për caktimin e paraburgimit, duke mos vlerësuar si duhet rrezikshmërinë e situatës si dhe të kryerësve të veprave penale, ku të dëmtuarit kanë qenë pa mbrojtje, kjo për faktin se të dyshuarit kanë poseduar të dhënat e tyre personale dhe janë ndjerë të frikësuar e të kanosur, ashtu që, të dyshuarve ju është lënë mundësia që të ndikojnë në fshehjen dhe asgjësimin e provave të veprave penale të kryera. Prokurori Aliu, nuk i ka pranuar dhe ka refuzuar udhëzimet dhe ndihmën profesionale nga Udhëheqësja e Departamentit të Përgjithshëm, si udhëheqëse e drejtpërdrejtë e tij.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit Hetimor dhe Prokurorit Lulzim Aliu, me shumicë të votave erdhi në përfundim se, në rastin konkret nuk janë gjetur elemente të përgjegjesisë disiplinore.

Sipas Këshillit Prokurorial se, a e ka vlerësuar drejtë apo jo prokurori – subjekti i hetimit, çështjen e recidivizmit, si kusht për caktimin e masës së paraburgimit, nuk është shkelje disiplinore por çështje e vlerësimit nga Komisioni për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve.

Nga se u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të vlerësimit të çështjes morri vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial i Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Zejnullah Gashi, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- Z. Lulzim Aliu, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.